

NJË PËRMBLEDHJE LIRIKASH ARBËRESHE E TOMAZO KAMPERAS NGA MASHKITI (A COLLECTION OF ARBËRESH LYRIC POEMS BY TOMMASO CAMPERA FROM MASCHITO)

Italo COSTANTE FORTINO

Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, Università degli Studi di Napoli, Itali

E-mail: costante.fortino@tin.it

PËRMBLEDHJE

Pakica gjuhësore arbëreshe mbetet prodhuese edhe sot pas pesë shekujsh që nga fillimi i ngulimeve në Itali. Një shkrimtar bashkëkohës arbëresh nga Mashkiti në Basilikatë është Tomazo Kampera i cili po na ofron një përmbledhje lirikash me vlerë të lartë estetike. Ai në gjuhën amtare të katundit të tij na çon në një udhëtim nëpër kulturën arbëreshe me një ligjërim të pasur metaforash dhe figurash alegorike të ndryshme. Nga njera anë mund të ndjekim procesin e varfërimit të kulturës katundare, por nga ana tjetër edhe pasurimin e një kulture dhe të një gjuhe që flet me zë të lartë edhe sot në kohën e globalizimit.

Pikat kryesore të poezisë së Kamperës janë "koha", e kaluara dhe e tashmja, "toka", "përkatësia", "kthimi" dhe "katundi". Mbi të gjitha këto koncepte mbizotëron fenomeni i "emigrimit" me aspektet pozitive dhe negative. Sidomos këto të fundit janë ato që prekin fantazinë e poetit kur i paraqet si çrrënjosje kulturore, si çarje nga bota e ndjenjave, nga koha e foshnjërisë, nga kultura amëtare që nuk mund të rikrijohet në mjedisin e ri qytetar. Por ndërgjegja e tij i sugjeron që nga takimi i botave të ndryshme "*Ze një pastan i re*", lind një vresht i ri.

Fjalët kyçe: lirika, arbëreshe, Tomazo Kampera, Mashkiti.

Key-words: Lyrics, arbëresh, Tommaso Campera, Maschito.

Ndër pakicat gjuhësore historike italiane, ajo që gjatë pesë shekujsh dhe gjer më sot ka prodhuar, në mënyrë të vazhdueshme dhe në nivel të lartë, vepra letrare të pasura nga pikëpamja e temave dhe e formës, është ajo arbëreshe. Edhe sot faza bashkëkohëse, që nisi që nga vitet '50 të shekullit të kaluar, paraqitet e pasur me emra autorësh dhe me vepra sidomos në poezi, por edhe në prozë, që tërheqin vëmendjen e kritikëve, aq përsa i përket zhvillimit të temave që ata trajtojnë, sa edhe për shprehjet dhe aspektet gjuhësore.

Për këto aspekte sjell në vëmendjen tuaj studimin tim: *Prirje gjuhësore të shkrimtarëve arbëreshë bashkëkohës* (Fortino: 377-406), ku kam rrahur sidomos çështjen e gjuhës arbëreshe të shkruar, si e kanë zgjidhur praktikisht autorët e ndryshëm në veprat e tyre, me variante që varen nga koha, nga kultura gjuhësore e autorit, nga gjinia e veprës dhe në fund nga qëllimi për të cilin shkruan autori.

Përsa i përket zonave prej të cilave kanë prejardhjen autorët arbëreshë bashkëkohës vendin e parë e zë Kalabria e ndjekur nga Sicilia, nga Bazilikata, nga Molize, nga Pulja dhe nga Kampania.

Në një katund arbëresh të Bazilikatës, Mashkiti, është lindur Tomazo Kampera, një poet jo shumë i ri – është i vitit 1949 – i cili në vitin 2004 ka botuar një përmbledhje të shkurtër me titull *Poesie insolite* (Poezi të pazakonta) që përmban vetëm 8 lirika. Sot

poeti Kampera është në takimin e dytë me poezinë, dhe po boton përmbledhjen me titull *Ze një pastan i re* (Mbin një vresht i ri) e cila përmban 30 lirika arbërisht me përkthimin italisht përbri dhe me një studim hyrës timin, nga i cili sintetizoj disa mendime që po shpreh sot.

1. PËRMBLEDHJA “ZE NJË PASTAN I RE”

Kjo përmbledhje ka rëndësi për dy arsye: 1) së pari sepse është një zë i veçantë që flet në gjuhën e folur të katundit arbëresh Mashkiti, për të pohuar gjallërinë kulturore arbëreshe të vendit; 2) së dyti sepse është një kontribut i vlefshëm për krijimin letrar arbëresh.

Poezia e Kamperës rrënjësohet në shprehjen popullore të të folmes së Mashkitit dhe nuk refuzon pëlhurat tradicionale, larmitë e ngjyrave të shprehësisë së një gjendjeje me një përvojë të veçantë, me një kulturë, me një ndjeshmëri dhe një pamje të vetën të botës.

Vlerës poetike i shtohen të dhënat antropologjike që përfshijnë të kaluarën dhe të tashmen duke nënvizuar elementet kulturore që përcaktojnë komunitetin gjatë procesit të evoluimit.

Zëri i Kamperas futet në kuadrin e poezisë arbëreshe që rendit, si pikë referimi, emrat e Jul Varibobës, i cili shkruan në të folmen e katundit të vet duke pranuar shumë italianizma, të Jeronim De Radës, që mbështet veprat kryesore në motivet e rapsodive popullore, dhe të Vorea Ujkos, i cili zbulon botën e zhytur arbëreshe që i frymëzon veprën letrare.

Kështu edhe Tomazo Kampera kalon një përvojë poetike të ngjashme. Ai është një emigrant në veri të Italisë, ku pas disa vitesh zbulon se brenda vetvetes ruan një thesar kulturor që më parë nuk kishte vlerësuar. Nga kjo përvojë shpirtërore e brendshme që ai ndjen lind poezia lirike që paraqitet si një udhëtim.

Përsiatja ndalet në konceptin e “kohës”, ku përfshihet e kaluara dhe e tashmja, në konceptin e “dheut”, në konceptin e “përkatësisë”, në atë të “kthimit” dhe në fund në konceptin e “katundit”. Poezia e Kamperës, megjithatë, përshkohet nga përvoja e emigracionit, e parë nga pikëpamja pozitive, siç është mirëqenia ekonomike, por edhe negative siç është çrrënjësia kulturore, thyerja që pëson bota e ndjenjave dhe bota e përkatësisë, që është vështirë të rikrijohet në mjedisin e ri.

2. FJALËT ARBËRESHE

Gjuha e fëmijërisë, e braktisur për arsye të lidhura me emigracionin drejt krahinave më të pasura të Italisë së veriut, nuk është fshirë nga koha, sepse është një thesar që pranohet si trashëgim. Disa njerëz marrin si trashëgim toka, disa të tjerë marrin para, por poeti Kampera pretendon nga e ëma, si trashëgim, gjuhën arbëreshe. Me këtë kuptim mund të lexohen vargjet që pasojnë:

*Ndë vresht e dhe
të m'lesh nëng ke
ëma atë që më përket...
ëma atë gluh arbëreshe!
Ëmi ato fjalë, një a një
... si thithurë klumshti
Po ëmi arbëreshe,
jo, tjetar mos më jip! (Gluhan a mëmës)*

Idea e Kamperës është që integrimi i njeriut në një kontekst kulturor që ndryshon nga ai i prejardhjes, mund të bashkëjetojë me kulturën e re që takon. Edhe me takimin e botës së re personi mund ta vlerësojë identitetin e vet, bile mund ta përforcojë vetëdijen se është i nevojshëm pranimi i larmive të kulturave dhe të gjuhëve. Ky mesazh rrjedh i fortë dhe ka shumë peshë sepse rrjedh nga përvoja personale e Poetit dhe vërtetohet çdo ditë nga jeta multietnike që po formohet pa ndërprerje në mjediset europiane.

3. KTHIMI

Ky i Kamperas është tregimi poetik i përvojës së vet. Pas largimit, Poeti kthehet në vendet e shtrënjta dhe takohet me mjediset afër shtëpisë së tij që përfaqësojnë lidhjen me botën e jashtme dhe që nuk mund të fshihen kurrë nga mendja. Këto vende në poezi përfaqësohen me “gurët”, një imazh poetik shumë shprehës dhe shumë familjar për ata që njohin ashpërsinë e jetës. Një vend të veçantë luan mjedisi që arbërisht quhet “gjitoni”, d.m.th. fqinjësia, që mund të përcaktohet si “katër dyer që hapen në një shesh të vogël”, vendi i komunikimit dhe i shkëmbimeve të përvojave ndërpersonale. Aty është zhvilluar shoqërizimi i parë që Poeti nuk mund ta harrojë sepse bën pjesë në jetën e pashlyeshme të fëmijërisë. Procesi poetik i kthimit në vitet më të çmueshme të jetës së tij, është procesi i ripërtëritjes,

ku kalojnë pamjet e botës së punës, shumë të rëndësishme për mbijetesën e kohës dhe ende kalojnë të shpërfytyruara figurat e punëtorëve, gati si fatosa dhe mjeshtër të prodhimit, fushat e grurit të artë, të përkëdhelur nga era. Në përfytyrimin e Poetit është puna, fuqia e përrjetshme që shkruan historinë e njeriut. Është parmenda, pena e hollë e bujkut, që shkruan, në faqen e shtruar në diell, historinë më të vjetër të njeriut.

4. DIASPORA

Poeti ndjen brenda vetvetes një gjendje të paqëndrueshme që mund të identifikohet me gjendjen e diasporës. Ndien brenda që prejardhja nuk është ajo e të gjithë atyre që e rrethojnë, por ndien edhe që katundi i lindjes është larg nga katundi i punës. Kështu që ndihet pak i çrënjësor, i përkohshëm. Poeti Kampera dëshiron të mbajë bashkë dy botë, ose më mirë tri botë: italiane, arbëreshe, shqiptare. Por nga këto tri botë, ajo që i frymëzon poezinë më të fortë është bota arbëreshe, ajo e vërtetë e fëmijërisë. Përqafon botën italiane sepse është ajo që i jep fuqi ekonomike, i garanton jetesën, përqafon atë shqiptare sepse e çon në kohën e lashtë, në prejardhje që e mburr; dhe në zemër ka botën arbëreshe që i flet fjalë të verteta, që e lidhin me gurët e shpive të katundit. Poeti me nostalgji kthehet në katund, dhe ecën nëpër udhat e qeta dhe të shkreta, të shpopulluara.

Përvoja e Poetit ka edhe aspekte të hidhura, që e lënë pa fjalë ose me fjalë të ndërprera, të këputura. Poeti vërteton që ka arbëreshë të cilët për arsye ekonomike kanë braktisur katundin e lindjes dhe nuk kthehen më atje. Jo vetëm kështu, por ka arbëreshë që harrojnë katundin, kulturën, gjuhën, dhe disa kanë harruan edhe nënën. Diaspora ka shkakuar edhe këtë gjendje tronditëse. Thirrja e shqetësuar e Poetit mishërohet në ritmin e vargut: *hora ima vëdes*, që është edhe titulli i një lirike.

Me horën vdes një botë, ajo më e shtrenjta e Poetit, vdes një pjesë e rëndësishme, zhduket përgjithmonë. Dhe Poeti nuk e pranon. Ai ndjen një revoltë të brendshme, një fuqi ripërtëritëse që e çon në kthimin e përmendur më parë: kthimi në kulturën e prejardhjes, në gjuhën e nënës, në vlerat tradicionale dhe në planin që parashikon bashkëjetesën e së kaluarës me të tashmen.

5. SHPREHJA GJUHËSORE

Tematikat poetike të poezisë së Kamperas kanë një-kohësisht shijen e së kaluarës, por edhe të së tashmes: për shembull modeli i jetesës së katundit, që tanimë i përket një bote që gati nuk ekziston më, frymëzon një lirikë me ngjyra të gjalla dhe këto imazhe bashkë-jetojnë me gjendjen e brezit të ri që jeton me një farë mendjelehtësie braktisjen e katundin duke e konsideruar si mbeturinë të së kaluarës.

Nga pikëpamja gjuhësore gjindemi përpara një gjuhe me trajta arkaike dhe me trajta rë reja.

Qoftë nga ana e argumenteve, qoftë nga ajo e shprehjes gjuhësore duket se Kampera ka pasqyruar gjendjen e kulturës arbëreshe sot, me aspektet romantike dhe ato realiste.

Duhet të shtohet që të gjitha poezitë janë përkthyer në italisht nga vetë autori, për të përhapur bazën e lexuesve, por siç pohon ai, ky përkthim nuk ka mëtime të veçanta dhe nuk arrin të krijojë kushtet e regëtimave të shprehjeve arbëreshe, sepse italishtja ka tinguj të tjerë që nuk ndjellin lidhjet dhe atmosferën e veçantë të mjedisit dhe të kulturës arbëreshe.

Struktura gramatikore e gjuhës së poezive të Kamperas paraqitet e larmishme: 1) me elemente konservative, 2) me elemente inovative.

ASPEKTE ARKAIKE

Duke lexuar këto poezi bien në sy lidhjet bashkë-tingëllore arkaike /kl/, /gl/, me shprehje si *gluha jonë*, *klumësht*, që karakterizojnë të folmen e Mashkitit, si edhe disa të folme të tjera. Këto na risjellin ndër mend format që hasim në *Mesharin* e *Buzukut*: *kle dërguom* (Çabej: 33), *të jetësë glatë* (Çabej: 25), si edhe në veprën e Lukë Matrëngës: *kle vënë* (Sciambra: 31), *të glarë* (Sciambra: 27).

Një trajtë tjetër konservative është ruajtja e zanores së dobët /ë/ në fund të fjalës në rrokje të theksuar dyparafundore ose madje në rrokjen e katërt nga fundi: *suvalatë* (shih: poezia *Fanari*) ose *qarami-dhëvatë* (shih: poezia *Kukuvoazhan*), edhe këto forma konservative i hasim në veprat e *Buzukut* dhe të Matrëngës.

ASPEKTE INOVATIVE

Megjithatë edhe e folmja e Mashkitit gjatë shekujve ka pësuar evoluime dhe inovacione. Ato më të sipikatshmet i përkasin fonetikës:

1) palatalizimi i bashkëtingëllores anësore alveolare /l/ në /λ/, kështu fjala *lis* shqiptohet *λis*;

2) fenomeni që po zhvillohet edhe sot i anësore alveolare dhëmbore /ll/ kryesisht në bashkëtingëllore fërkimore uvulare /ɣ/, por edhe në anësore alveolare /l/: *këmiri* (shih: *U prora*), por edhe *mjegull* (shih: *Mjegullan*);

3) kalimi i zanores /e/ në /a/ në pozitë pretonike dhe postonike: fjala *bekuarë* shkon në *bakuarë* (shih: *Hora ima vëdes*), si edhe *sonde* shkon në *sonda* (shih: *Për nderin të i ndëlimi tatës*).

Ndërsa në morfologji mjafton të citoj:

1) prirjen e emrave mashkullorë të përgjithësimit për të formuar shumësin mashkullor me mbaresën -a që, për analogji, ka si rrjedhim ndryshimin e gjinisë, siç mund të vërtetohet lehtë me përkimin e mbiemrave: *ulka t'egra* (shih: *Tura agughuar*), *mota të shkuara* (shih *Besan*);

2) mungesën e ndërrimit zanor gjatë zgjedhimit të disa foljeve: *je/o*; dhe për këtë arsye hasim në aoristin (e kryera e thjeshtë) formën *pjela* dhe *jo polla*.

3) futjen, në kohën e aoristit, të grupit bashkëtingëllore -jt- midis temës dhe mbaresës, në vend të bashkëtingëllores -v-. Kështu, në vend të formës *push-trova* haset forma *pushtrojta* (shih *Besan*).

4) një fenomen tjetër, që paraqet ndoshta inovacionin më të madh në strukturën e gjuhës është sinkretizimi i disa rasave, për arsye të fenomenit të analogjisë dhe ndoshta për ndikimin e strukturës gjuhësore të italishtes. Prandaj mund të hasim *luft-ova armiku i padukshim* (shih *Për një grua*), në vend të *armikun e padukshim* në rasën kallëzore; ose forma të tipit *mbi kurmi i saj* (shih: *Lindja*). Kemi edhe raste ku sinkretizimi përqendrohet në rasën emërore, siç na tregojnë këta shembuj: *këndon cinxërran* (shih *I urti shkrimtar*), ose *marrur nga gjeghan* (shih *Kroi arës*) (*gjellën*);

5) në sintagmën emër plus emër në rasën gjinore, ose emër plus mbiemër shpesh mungon nyja lidhëse. Prandaj hasim: *praku derës* (shih *Sumzat*); *kurmi përu-lur* (shih *I urti shkrimtar*), sipas dëshmimeve të autorëve të vjetër.

Në fushën e leksikut, poeti Kampera ka vlerësuar të gjithë trashëgiminë arbëreshe ende të gjallë; ka

shfrytëzuar edhe mundësitë e fjalëformimit nëpërmjet prapashtesimit dhe ka pranuar pak italianizma që, megjithatë, janë fort të pranishme në të folmet arbëreshe. Kështu Poeti nuk u ka dhënë shumë hapësirë fjalëve të marra nga shqipja standarde.

PËRFUNDIM

Kultura arbëreshe, me fjalë të tjera, ka përcaktuar identitetin e vetë, gjatë pesë shekujve në kontekstin italian jugor: në fushën letrare ka prodhuar vepra që karakterizohen si për ndikimin e kulturës italiane ose perëndimore në përgjithësi, ashtu edhe për ruajtjen e tipareve dhe të limfës që rrjedh nga rrënjët arbëreshe. Edhe në fushën gjuhësore janë të pranishme pasojat e takimeve me gjuhën italiane ose romane jugore. Këto pasoja mund t'i ndeshim sidomos në fushën leksikore, ku rrënjë italiane janë futur në sistemin e arbërishtes, duke u klimatizuar aq mirë sa të arrijnë të tradhëtojnë edhe vetë origjinën. Por në kohët e fundit ky klimatizim nuk punon më, bile zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga fenomeni i një forme gjuhëpërzierjeje.

Kultura e sotme arbëreshe ruan një përvijim që dallohet si nga kultura italiane ashtu edhe nga ajo shqiptare, nga e cila është shkëputur prej pesë shekujsh: ajo ruan tipare që janë pasoja e evoluimit historik në kontekstin kulturor perëndimor italian.

Përmbledhja e lirikave të Kamperas për imazhet që pasqyrojnë fragmente të çmueshme të një kulture shekullore, për harmoninë e tingujve të gjuhës arkaike dhe njëkohësisht të ndryshuar, përfaqëson një kontribut me vlerë për njohjen e një bote të kaluar por ende të pranishme dhe është një monument gjuhësor i të folmes së katundit Mashkit, deri tani e njohur vetëm në nivelin gojor.

BIBLIOGRAFIA

1. FORTINO, I.C. (2003), *Prirje gjuhësore të shkrimtarëve arbëreshë bashkëkohës*, në *Konferenca shkencore – Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Akademia e Shkencave–Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.
2. ÇABEJ, E. (1968), *Meshari i Gjon Buzukut*, Pjesa e dytë, Tiranë.
3. SCIAMBRA, M. (1964), *La "Dottrina cristiana" albanese di Luca Matranga*, Città del Vaticano.